



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2019:224124

Datë: 02.08.2024

Numri i dokumentit: 06014193

AC-I.-24-0298

Në ankesën e

Paditësja/ankuesja

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), rr "Driton Hoxha", nr. 55, Lakrishtë,
Prishtinë.

Ndërrhyrësi Kryesor

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) – Prishtinë

Kundër

Të paditurit

B A dhe H A Mitrovicë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses dhe të paditurës të paraqitur kundër Aktgjyqimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-22-0154, të datës 02 prill 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 02 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- Ankesa e paditëses-AKP-së dhe e të paditurës H A të paraqitura kundër Aktgjyqimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-22-0154, të datës 02 prill 2024, refuzohen si të pa bazuara.**
- Vërtetohet Aktgjykimi Shkallës së parë i DHPGJS-së, C-III-22-0154, i datës 02 prill 2024.**
- Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 22 tetor 2007, Paditësja-AKP ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, kundër të paditurit B A nga Mitrovica, për shkak të lirimit të pronës së uzurpuar – objektit prapa ndërtesës së ish Bankës Themelore “Jugobankës” .

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin e saj C.nr.613/07 të dt. 16 nëntor 2021, është shpallur in kompetente dhe lëndën me të gjitha shkresat ia ka dërguar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në kompetencë të mëtejme.

Lënda në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS), është regjistruar si C-III-22-0154.

Shkalla e parë e DHPGJS, duke vepruar sipas kësaj lëndë e ka dërguar për përgjigje padinë e paditësit, i cili e ka paraqitur përgjigjen me 07 nëntor 2023 kurse, me 16 nëntor 2023 kjo gjykatë ka mbajtur seancë dëgjimore, ku ka prezantuar vetëm përfaqësuesi i palës paditëse kurse, për palën e paditur gjykata nuk kishte provë se është ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësja – përfaqësuesi i AKP me 21 nëntor 2023, ka paraqitur parashtresë për rregullimin – precizimin e padisë, për faktin se tani kanë ndryshuar rrethanat nga se Qeveria e Kosovës objektin e padisë respektivisht pronën kontestuese e ka shpronësuar për interes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Pra, si përfaqësuese e NSh-së “Jugobanka” (MIT101), në Mitrovicë dhe mbi bazën e këtyre rrethanave të krijuara e paditura AKP ka propozuar që të Aprovohet kërkesëpadija e saj dhe të obligohet i padituri që në emër të dëmit real dhe fitimit të humbur për shfrytëzimin e sipërfaqeve të pronës së tokës në sipërfaqe të përgjithshme prej 98 m2, pjesë e ngastrës kadastrale nr..., pronë e NSh “Jugobanka”- Mitrovicë, ZK Mitrovicë, për periudhën prej dt.01.01.2004 deri me dt.31.05.2022, ti paguaj paditëses shumë prej 34.400 € me kamatë ligjore prej 8% vjetore sipas LMD, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Me 23 nëntor 2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka paraqitur Kërkesë pran DHPGJS-së duke kërkuar ti pranohet cilësia si ndërhyrës kryesor në procedurë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palës në procedurë. Kjo për faktin se toka dhe objekti

nr...ZK Mitrovicë NSH "Jugobanka" (MIT101), në Mitrovicë tani evidentohet në emër të KGJK-së për nevojat e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në përputhje me vendimin përfundimtar për shpronësim të Qeverisë së Kosovës nr.20/67 dt.09.03.2022. Parashtresës i ka bashkangjitur Vendimin e AKP Nr.Ref.BD-164/16 dt.01.06.2022, Vendimin Përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.20/67 dt.09.03.2022 me dokumente përcjellëse.

Me 01 dhjetor 2023, paditësja Agjencia Kosovare e Privatizimit si përfaqësuese e NSH "Jugobanka" është përgjigjur në urdhrin e Gjykatës në të cilin ka përkrahë kërkesën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe i ka propozuar Dhomës së Posaçme që ta aprovoj kërkesën e ndërhyrësit si të bazuar, ashtu që KGJK-së ti pranohet cilësia e ndërhyrësit kryesor më të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palës në procedurë.

Me 27 dhjetor 2023, urdhrin i është përgjigjur edhe pala e paditur – B A nga Mitrovica respektivisht këtë kërkesë në emër të paditurit e ka parashtuar H A. E njëjta ka pohuar faktin se me bashkëshortin e saj jetojnë dhe banojnë në objektin kontestues ndërsa, B A si i paditur ka vite që nuk jeton në këtë objekt. Arsyeja se të njëjtit jetojnë aty është se janë të moshës së shtyer, invalid, jetojnë nga pensioni i pleqërisë dhe nuk kanë vend ku të strehohen. Për më tepër ka shtuar se ky objekt nuk është pronë e ish Jugobankës të cilën e menaxhon AKP-ja, sipas saj ky objekt ka qenë kafene të cilën e ka mbajtur personi i quajtur S M dhe konsiderojnë se është pronë private apo eventualisht mund të jetë pronësi shoqërore nën menaxhimin e Komunës së Mitrovicës.

Shkalla e parë e DHPGJS, duke u bazuar në parashtresën e lartë përmendur të KGJK-së, si dhe provave të bashkangjitura, vendosi që ta lejoj që KGJK-në të kyqet në këtë procedurë si ndërhyrës kryesor, ashtu siç ka vendosur në dispozitiv të aktvendimit të dt.04.01.2024, bazuar në nenin 266 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili parasheh që: *"Personi që tërësisht apo pjesërisht e kërkon sendin apo të drejtën lidhur me të cilën është në zhvillim e sipër procedura midis dy palëve ndërgjyqëse, mundet që në gjykatën e çështjes t'i padisë ato me padinë e tij deri në përfundimin e procedurës me vendim të formës së prerë (ndërhyrja kryesore)."*

Më 31 janar 2024, Shkalla e parë ka mbajtur seancë dëgjimore, ku ka prezantuar përfaqësuesi i palës paditëse dhe përfaqësuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ndërsa nuk ka prezantuar i padituri B A i cili është ftuar në mënyrë të rregullt mirëpo, mos ardhjen e tij nuk e ka arsyetuar.

Me 07 shkurt 2024, AKP si paditëse në këtë lëndë ka dorëzuar parashtresë për rregullimin – precizimin e padisë. Më anë të kësaj parashtresë ajo thekson se bënë zgjerimin e padisë në kuptimin subjektiv që përpos B A si palë e paditur është edhe H A. Kurse në aspektin objektiv pasi kanë ndryshuar rrethanat ka ndryshuar edhe objekti i kërkesëpadisë dhe atë për shkak se Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim ka shpronësuar, për interes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës objektin i cili është uzurpuar, andaj në bazë të rrethanave të reja të krijuara AKP-ja si përfaqësuese e “Jugobankës” bëri rregullimin – precizimin e padisë në objektin e kërkesëpadisë dhe është tërhequr nga kërkesa për uzurpim. Më tutje ka mbetur pranë precizimit të dt. 21.11.2023 sa i përket dëmit real dhe fitimit të humbur nga i padituri me shfrytëzimin e pronës kontestuese të lartë cekur.

Me 16 shkurt 2024, i padituri B A ka parashtruar një përgjigje në urdhër me të cilin thekson se pronën e kanë uzurpuar pas luftës por që nga viti 2017 ai nuk jeton më në at pronë. Prind e tij janë të sëmurë dhe vuajnë nga shumë probleme shëndetësore. Vet thekson se jeton më një pension të veteranit të luftës.

Me 16 shkurt 2024, e paditura e dytë H A parashtron një përgjigje në urdhër me anë të cilit i propozon gjykatës që të refuzohet në tërësi precizimi i padisë. Nga se në objektin kontestues jeton me bashkëshortin që të dytë janë të sëmurë dhe në moshë të shtyrë, se jetojnë në kushte të vështira ekonomike, me një pension të pleqërisë, se mbas luftës janë strehuar në atë objekt dhe se i është drejtuar organeve të ndryshme për t’iu siguruar strehim por, pa sukses.

Me 16 shkurt 2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka parashtruar precizimin e padisë me të cilin thekson se bënë zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv ashtu që përpos të paditurit B A tani e tutje të paditur do të jenë edhe H A dhe bashkëshorti i saj H A. Ndërsa, sa i përket objektit të kontestit, ndërhyrësi ka interes juridik vetëm për lirimin e pronës kontestuese dhe jo për pjesën tjetër të kërkesëpadisë të specifikuar nga paditësi kryesor.

Me 11 mars 2024, Shkalla e parë ka mbajtur seance dëgjimore të radhës.

Më 02 prill 2024, Shkalla e parë e DHPGJS-së me aktgjykimin C-III-22-0154 ne piken 1 e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit- ndërhyrësit kryesor KGJK-së, dhe ka obliguar të paditurit B A dhe H A ta lirojnë nga njerëzit dhe sendet objektin të cilin e mbajnë në shfrytëzim në sipërfaqe prej 98 m², pjesë e ngastrës kadastrale .. ZK Mitrovicë, pronë e ish NSh "Jugobanka" Mitrovicë, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Në piken 2 e ka refuzuar kërkesëpadia e paditëses AKP, me të cilën ka kërkuar që të paditurit për periudhën prej dt. 01.01.2004 deri me dt. 31.05.2022 ti paguajnë paditëses shumë prej 34.400 euro me kamatë ligjore prej 8 % në vit sipas LMD.

Shkalla e parë ka arsyetuar se nga provat e administruara vërtetohet se në këtë çështje, nuk është kontestuese se paluajtshmëria kontestuese ishte pronë e ish NSh "Jugobanka", po ashtu nuk është kontestuese se objektin në sipërfaqe të përgjithshme prej 98 m², pjesë e ngastrës kadastrale nr..., e që ishte pronë e ish NSh Jugobanka në Mitrovicë, fillimisht i padituri B A e kishte uzurpuar menjëherë mbas luftës, në të cilin objekt kishte qëndruar deri në vitin 2017. Pastaj mbas zhvendosjes së tij, në objektin në fjalë kishin mbetur prindërit e tij H dhe H A të cilët edhe tani qëndrojnë. Po ashtu, nuk ishte kontestues fakti se e paditura H A dhe bashkëshorti i saj janë të shtyrë në moshë, të gjendjes së dobët ekonomike dhe që të dytë vuajnë nga sëmundje të ndryshme, fakte që vërtetohen nga provat e prezantuara. Duke u bazuar në këto rrethana dhe faktet e vërtetuara Shkalla e parë kishte vendosur lidhur me padinë e precizuar në kuptimin subjektiv paditësit - përfaqësuesit të NSh – AKP-së që si e paditur e dytë të jetë H A të cilën e aprovoi ndërsa, sa i përket precizimit të padisë në kuptim objektiv që ka të bëjë me dëmin real dhe fitimin e humbur për periudhën kohore prej 01.01.2004 e deri më 31.05.2022 , e kishte refuzuar si të pabazuar.

Tutje Shkalla e parë kishte arsyetuar se me rastin e administrimit të provave të prezantuara nga ndërhyrësi kryesor gjykata vërtetoi se është e pakontestueshme se për paluajtshmerin dhe objektin parcelën nr. ..ZK Mitrovicë pronë e ish Jugobanka (MIT101), me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës të 20/67 të dt. 09.03.2022, ishte miratuar shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish shoqëror, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe në pikën 3 ishte paraparë renovimi dhe ndërtimi

i ish objektit të "Jugobanka " Filiala në Mitrovicë, për nevoja të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, parcelat (toka dhe objekti) ish prona shoqërore nr.. dhe .. ZK Mitrovicë.

Ndërsa, nga vendimi i dt. 01 qershor 2022, Shkalla e parë vërtetoi se Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit kishte aprovuar transferimin e pronës -prona e paluajtshme me parcelat (toka dhe objekti) ngastrat nr. . dhe .. ZK Mitrovicë nga ish NSh "Jugobanka" në Mitrovicë, në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për nevojat e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, vendim ky që ishte në përputhje me vendimin përfundimtar për shpronësim 20/67 të dt.09 mars 2022. Në kuptim të vërtetimit të gjendjes së fakteve, shkalla e parë kishte vlerësuar edhe pretendimet e paditurës e cila në vazhdimësi ka theksuar se me bashkëshortin nuk kanë vend strehim dhe se kjo është pronë e Komunës dhe nuk mund të largohen derisa tu bëhet zgjidhje, por të njëjtat nuk u morën për bazë për faktin se prona asnjëherë nuk kishte qenë në pronësi të Komunës së Mitrovicës dhe shpronësimi i kësaj prone për interes publik është me rëndësi të veçantë.

Sa i përket kompensimit të kërkuar nga AKP-ja , nga shkresat e lëndës ishte vërtetuar se nuk është kontestuese se i padituri i parë B A nga viti 2017 ka liruar objektin kontestues. Këtë objekt i njëjti e mbajti gjer në atë kohë duke e shfrytëzuar si strehim të domosdoshëm së bashku me familjen e tij, duke qenë përfitues i asistencës sociale. E paditura e dytë e cila aktualisht gjendet në shfrytëzim të kësaj prone, me dëshmitë e parashtruara provoi se është përfituese e asistencës sociale me nevoja të veçanta. Sipas pohimit të saj prona kontestuese është pronë e Komunës. Nga këto rrethana Shkalla e parë kishte konsideruar se e paditura nuk ka pasur njohuri se kjo pronë është në pronësi të NSH-së dhe gjendja e saj ekonomike e saj, si përfituese e asistencës sociale, i pamundëson pagesën dhe obligimet për shfrytëzim të objektit ashtu siç kërkon AKP-ja. Në mungesë të dëshmimeve, pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paluajtshmërinë tani të shpronësuar, nuk ishin të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar.

Më 12 prill 2024, e paditura H A ka parashtruar ankesë pranë Kolegjit të Apelit dhe kërkon që aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë organit të shkallës së parë në rivendosje. Në ankesën e parashtruar e paditura ka shtuar se me bashkëshortin banojnë në një objekt-shtëpi të dëmtuar e cila nuk përmbushë

as kushtet elementare të banimit dhe atë për faktin se bashkëshorti i saj vaun nga kanceri ndërsa e paditura brenda mundësive materiale mundohet që të kujdeset për bashkëshortin e saj. Pranë gjykatës së shkallës së parë kanë prezantuar dokumentacionin mjekësor, një incizim mbi kushtet e banimit mirëpo që nga përfundimi i procedurës për largimin e të paditurve, të paditurit e kanë kontestuar faktin se pjesa ku banojnë nuk është në pronësinë e AKP-së apo të KGJK-së, siç ceket në aktgjykimin e ankimuar. Tutje thekson se pjesa ku jeton me bashkëshortin nuk është në pronësinë e Jugbankës, AKP-së apo Këshillit Gjyqësor, por është pjesë është e Kuvendit Komunal të Mitrovicës, por që askush që nga fillimi i procedurës për largimin tim nuk ka dashur që ti verifikojë këto rrethana se pjesa e banimit në pronësi të kujt është. Për ti vërtetuar këto rrethana Gjykata e Shkallës së parë është dashur që të angazhoi ekspertin e gjeodezisë i cili do të verifikonte parcelat kontestuese apo të vërtetonte se pjesën të cilën e shfrytëzoi është në pronësinë e Komunës së Mitrovicës apo siç pretendohet në aktgjykimin e ankimuar.

Më 17 prill 2024, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka parashtruar ankesë kundër Aktgjyimit të Kolegjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nr.C-III.-22-0154, për shkak të gjitha arsyeve ankimore me të cilën ka propozuar që aprovet ankesa si e bazuar, të anulohet pika e dytë e Aktgjyimit C-III.-22-0154 i datës 02.04.2024, të obligohen të paditurit në emër të dëmit real dhe fitimit të humbur për shfrytëzimin e sipërfaqeve të pronës së tokës në sipërfaqe të përgjithshme prej 98 m² pjesë e ngastrës kadastrale .. pronë e PSH" Jugobanka" Mitrovice, ZK Mitrovice, për periudhën prej datës 01 janar 2004 deri më 31 maj 2022, ti paguajë paditëses shumë 34.400 euro me kamat ligjore apo në rast se gjykata vendos që shumë të cakton eksperti gjyqësor financiar, me kamatë ligjore prej 8% në vit sipas LMD, të gjitha këto nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimi të ekzekutimit me dhunë.

Ka theksuar se Aktgjykimi i atakuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore nr.03/L-006, ashtu siç janë përcaktuar me neni 182 paragrafi 2, (n), pasi që aktvendimi ka të meta, sepse dispozitivi i Aktgjyimit është kontradiktor me arsyetimin. Aktgjykimi nuk përmban arsye dhe shpjegime ligjore në mes të asaj të thuhet në diapozitiv dhe arsyetimin e aktgjyimit, prandaj konsideron se ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në marrjen e aktgjyimit të pa bazuar në ligj.

Ka shtuar se Aktgjykimi ankimor mbështet në prova të pa vërtetuara dhe fakte relevante të pa adiminsturuara nga gjykata në mbështetje të nenit 8.2 të LPK-së, e gjykata në bazë të çmuarjes së çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, nga i cili duhet të nxirret konkludimi dhe të gjitha se bashku, nga i cili duhet të nxirret konkludimi por mbështet në supozimet juridike. Ky fakt rrjedh nga arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e konstatuar nga gjykata se paditësi ka paraqitur prova të cilat gjykata nuk i ka aprovuar. Andaj, nga kjo rezulton se gjykata nuk e ka mbështetur aktgjykimin në prova dhe fakte të besueshme në të cilat edhe në rrethanat faktike dhe procedurale. Andaj konstatimi i dhënë në dispozitivin e aktgjykimit se: "Refuzohet kërkesëpadia". Është i gabuar, nga se konkludimi dhe konstatimi i gjykatës duhet të mbështetet në bazë të provave dhe fakteve të administruara të vërtetuar nga gjykata. Po ashtu ka shtuar se sipas shpjegimit të dhënë nga Gjykata të rrethanat faktike dhe procedurale, në mes tjerash theksohet: "sa i përket kompensimit të kërkuar nga AKP-ja, nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestuese se i padituri i parë..., këtë objekt i njëjti e mbajti gjerë në atë kohë duke e shfrytëzuar si strehim i domosdoshëm së bashku me familjen e tij, duke qenë përfitues i asistencës sociale...". Vërtetim të gabuar gjykata në nxjerrjen e aktgjykimit AKP-ja konsideron se i padituri e ka shfrytëzuar objektin jo vetëm për banim të cilën e ka ofruar pala paditëse si provë po edhe për nevoja biznesore, andaj këtë fakt nuk e ka vërtetuar gjykata.

Gjithashtu Gjykata me marrjen e aktgjykimit ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga se pala paditëse në seancën e mbajtur i ka theksuar këto pretendime dhe se arsyetimi i dhënë nga gjykata nuk përshkon me gjendjen faktike e cila është në teren gjegjësisht me palët të cilët e kanë shfrytëzuar. Thekson se Aktgjykimi është nxjerrë me shkelje të dispozitave të LPK-së të përcaktuara me nenin 184, lidhur me zbatimin e gabueshëm të së drejtës materiale, kjo nga fakti se gjykata gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, duke nxjerrë aktgjykimin me të cilin e ka aprovuar padinë e paditësit. AKP konsideron se i padituri i ka shkaktuar humbje materiale paditësit duke mos e kompensuar për periudhën kontestuese.

AKP-ja konsideron se aktgjykimi me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit AKP-së është e pa bazuar në ligjin material përkatësisht Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve. Dhoma e Posaçme me aplikimin e dispozitës 54 pika 1 (Gjegjësisht të nenit 9.4.3) të Ligjit nr. 06/086, në mënyrë të gabuar ka aplikuar të drejtën materiale me rastin e marrjes së aktgjykimit për refuzimin e padisë, e që ka të bëjë

me nenin 183 të LPK-së. Andaj si pasojë e shkeljes esencaile të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pason edhe zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, respektivisht deri të aplikimi i të drejtave të cilat nuk i atakojnë të paditurit, në të cilat bazohet arsyetimi i atakuar.

Më 25 prill 2024, H A ka dorëzuar në Kolegjin e Apelit një deklaratë në formë të shkruar, në të cilën ka theksuar se nuk është i punësuar dhe nuk ka banesë dhe nuk ka shtëpi e as pronë të patundshme. Po ashtu ka shtuar se është invalid dhe se ka bërë operacion nga kanceri.

Më 15 korrik 2024, Ndërhyrësi kryesor/Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës, me të cilën ka propozuar që të refuzohet në tersi si e pa bazuar ankesa e të paditurve, e ushtruar kundrejt, Aktgjykimit C-III-22-0154, të datës 02 prill 2024, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë C-III.-22-0154, i datës 2 prill 2024. Ka shtuar se të paditurit as me ankesën e paraqitur nuk kanë arritur të paraqesin ndonjë bazë juridike të besueshme dhe as nuk kanë mundur të konstatojnë një gjendje tjetër faktike prej asaj siç është vërtetuar me aktgjykimin e Shkallës së parë të DHPGJS.

Më 18 korrik 2024, Paditësja/Agjencia Kosovare e Privatizimit ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës, me të cilën ka propozuar që të refuzohet në tersi si e pa bazuar ankesa e të paditurve, e ushtruar kundrejt, Aktgjykimit C-III-22-0154, të datës 02 prill 2024, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë C-III.-22-0154, i datës 02 prill 2024. Ka shtuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit në tersi e mbështet Aktgjykimin e dhomës së Posaçme nr. C-III-22.-0154, të Dhomës së Posaçme, duke e konsideruar si të drejtë dhe të ligjshëm që ka të bëjë me lirimin e pronës të cilën e shfrytëzon. Gjithashtu, Agjencia qëndron pranë të gjitha thënieve dhe provave të paraqitura nga ana e Kolegjit pranë DHPGJS lidhur me rastin C-III.-22-0154, me të cilat ka refuzuar të gjitha pretendimet e të paditurve.

Me 16 korrik 2024, këshilli Gjyqësor i Kosovës, në cilësinë e ndërhyrësit ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditurve, dhe të njëjtën e ka kundërshtuar në tërësi duke e konsideruara si të pabazuar. Ka shtuara se të paditurit nuk kanë

arritur as me ankesë të paraqesin denjë bazë juridike të besueshëm dhe nuk kanë mundur të konstatojnë denjë gjendej tjetër faktike prej asaj që është vërtetuara me Aktgjykimin e Shkalles së parë të DHPGJS C-III-22-0154. Tutje kanë theksuar se Aktgjykimi i Shkalles së parë i DHPGJS është i drejtë dhe i bazuar në Ligj, ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që ta vërtetoj te njëjtin ndërsa ankesën e të paditurve ta refuzoj si të pabazuar.

Me 18 korrik 2024, AKP ka parashtruar përgjigje ne ankesën e të paditurve duke e konsideruar si të pabazuar në ligj, ndërsa ka theksuar se mbështete Aktgjykimin e Shkalles së parë C-III-22-0154, si të drejtë dhe të bazuara në ligj. Ka shtuara se të paditurit nuk kanë arritur as me ankesë të paraqesin ndonjë bazë juridike të besueshëm dhe nuk kanë mundur të konstatojnë ndonjë gjendej tjetër faktike prej asaj që është vërtetuara me Aktgjykimin e shkalles së parë të DHP.

Më 08 korrik 2024, Gjykata ka lëshuar Urdhër për të paditurit në mënyrë që ata të mund të parashtrojnë përgjigje ndaj ankesës së AKP-së. Me 12 korrik 2024 të paditurit e kanë pranuar urdhrin për përgjigje ne ankesën e AKP-së , mirëpo të njëjtit nuk kanë parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditëses-AKP-së dhe e të paditurës refuzohen si të pa bazuara.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se më 22 tetor 2007, paditësja /AKP ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, kundër të paditurit B A nga Mitrovica, për shkak

të lirimit të pronës së uzurpuar – objektit prapa ndërtesës së ish Bankës Themelore “Jugobankës” .

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin e saj C.nr.613/07 të dt.16 nëntor 2021, është shpallur in kompetente dhe lëndën me të gjitha shkresat ia ka dërguar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në kompetencë të mëtejme .

Kolegji i Apelit vëren se paditësja -AKP përmes parashtresës se dt.21 nëntor 2023, ka bërë precizimin e padisë, dhe ka kërkuara nga Gjykata që të Aprovohet kërkesëpadia e saj dhe të obligohet i padituri që në emër të dëmit real dhe fitimit të humbur për shfrytëzimin e sipërfaqeve të pronës së tokës në sipërfaqe të përgjithshme prej 98 m², pjesë e ngastrës kadastrale nr..., pronë e NSH “Jugobanka”- Mitrovicë, ZK Mitrovicë, për periudhën prej dt.01.01.2004 deri me dt.31.05.2022, ti paguaj paditëses shumë prej 34.400 € me kamatë ligjore prej 8% vjetore sipas LMD.

Po ashtu Kolegji i Apelit vëren se Kolegji i Shkalles së parë i DHPGJS me Aktvendimin C-III-22-0154 të dt. 04 janar 2024 , e ka pranuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës si ndërhyrës kryesor në këtë çështje juridike dhe kjo pasi që Ndërhyrësi kishte kërkuar ti pranohet cilësia si ndërhyrës kryesor në procedurë. Kolegji i Apelit vëren se Ndërhyrësi Kryesor ishte pranuar pasi Gjykata kishte gjetur se toka dhe objekti nr..ZK Mitrovicë NSH “Jugobanka” (MIT101), në Mitrovicë tani evidentoheshin në emër të KGJK-së për nevojat e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në përputhje me vendimin përfundimtar për shpronësim të Qeverisë së Kosovës nr.20/67 dt.09.03.2022, dhe pasi që palëve në procedurë i është dhënë mundësi të paraqesin kundërshtimet e tyre rreth ndërhyrësit, të cilën Aktvendim për pranimin e ndërhyrësit Kolegji i Apelit e konsideron si vlerësim të drejtë dhe të ligjshëm, bazuar në nenin 266 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili parasheh që: *“Personi që tërësisht apo pjesërisht e kërkon sendin apo të drejtën lidhur me të cilën është në zhvillim e sipër procedura midis dy palëve ndërgjyqëse, mundet që në gjykatën e çështjes t’i padisë ato me padinë e tij deri në përfundimin e procedurës me vendim të formës së prerë (ndërhyrja kryesore).”*

Më 02 prill 2024, Shkalla e parë e DHPGJS-së me aktgjykimin C-III-22-0154 në pikën 1 e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit- ndërhyrësit kryesor

KGJK-së, dhe ka obliguar të paditurit B A dhe H A ta lirojnë nga njerëzit dhe sendet objektin të cilin e mbajnë në shfrytëzim në sipërfaqe prej 98 m², pjesë e ngastrës kadastrale .. ZK Mitrovicë, pronë e ish NSh "Jugobanka" Mitrovicë, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Në piken 2 e ka refuzuar kërkesëpadia e paditëses AKP, me të cilën ka kërkuar që të paditurit për periudhën prej dt. 01.01.2004 deri me dt. 31.05.2022 ti paguajnë paditëses shumën prej 34.400 euro me kamatë ligjore prej 8 % në vit sipas LMD.

Kundër këtij aktgjykim ankesë në Kolegjin e Apelit kanë parashtruar paditësja- AKP dhe e paditura H A.

Kolegji i Apelit i ka shqyrtuara dhe vlerësuar pretendimet ankimore të dy ankuesve, mirëpo nuk ka gjetura se ka shkelje, prandaj nuk mund të pajtohet me pretendimet e ankuesve.

Kolegji i Apelit ka vlerësuar pretendimet e paditëses lidhur me atë se aktgjykimi i ankimuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuara dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka gjetur se perëndimet e paditëses janë të pathemelta ngase Shkalla e parë ka vlerësuar provat e ofruara nga palët ndërgjyqëse dhe ka marr aktgjykim i cili sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit është i drejtë dhe i bazuar në Ligj. Kjo pasi që Shkalla e parë ka dhen arsye konkrete për faktet vendimtare duke dhen shpjegime dhe arsyet adekuate dhe të bazuar në dispozita ligjore që i referohen kësaj çështje juridike.

Po ashtu pretendimet e paditëses se Aktgjykim ankimuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182.2 pika n) sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit, nuk janë të themelta, kjo për shkak se Shkalla I-rë e ka garantuar objektivitet dhe ligjshmërinë e procesit gjyqësor duke kërkuara nga palët me shkrim përmes urdhrave dhe në seancën dëgjimore sigurimin e provave në mënyre që të konsistojë faktet thelbësore e për të cilat gjykata ka dhen arsyetimin e duhur.

Kolegji i Apelit po ashtu vlerëson se Shkalla e I-rë, ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme të drejtën materiale, andaj vlerëson po ashtu si të pathemelta pretendimet e paditëses se nuk janë aplikuar në mënyrë të drejtë dispozita ligjore.

Sa i përket perëndimeve të paditurës se pjesa ku jeton me bashkëshortin nuk është në pronësinë e Jug bankës, AKP-së apo Këshillit Gjyqësor, është e pabazuar nga se nga provat e prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Shkallë të parë dhe nga përgjigjja e paditëses AKP-së ishte vërtetuar se parcelat (toka dhe objekti) nr.608-1 dhe nr. ..ZK Mitrovicë e NSH "Jugobanka" (MIT101), në Mitrovicë me Vendimin Bordit të Drejtorëve të AKP-së Nr.Ref.BD-164/16, dt. 01 qershor 2022, ishin transferuara në emër të KGJK-së për nevojat e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në përputhje me vendimin për shpronësim të Qeverisë së Kosovës nr.20/67 të dt.09.03.2022. Pretendimi tjetër i të paditurës-ankueses se me bashkëshortin e saj banojnë në një objekt-shtëpi të dëmtuar e cila nuk përmbushë as kushtet elementare të banimit dhe atë për faktin se bashkëshorti i saj vaun nga kanceri ndërsa e paditura brenda mundësive materiale mundohet që të kujdeset për bashkëshortin e saj, ky pretendim mund të jetë i vërtetë, mirëpo kjo gjendje nuk mundë të evidentohet si shkelje ligjore nga ana e gjykatës, prandaj edhe nuk e ndryshon qëndrimin e Kolegjit të Apelit karshi Aktgjyqimit të atakuar.

Kolegji i Apelit i mbështet të gjeturat faktike të Shkallë të I-rë dhe konstatimet e dhënë në Aktgjykimin e ankimuar, pasi që ato i konsideron e si të drejta dhe të bazuara në ligj.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallë së parë se nuk është kontestuese se paluajtshmëria kontestuese ishte pronë e ish NSH "Jugobanka". Po ashtu nuk është kontestuese se objektin në sipërfaqe të përgjithshme prej 98 m2, pjesë e ngastrës kadastrale nr..., e që ishte pronë e ish NSH Jugobanka në Mitrovicë, fillimisht i padituri B A e kishte uzurpuar menjëherë mbas luftës, në të cilin objekt kishte qëndruar deri në vitin 2017. Siç nuk është konstatuese se mbas zhvendosjes së tij, në objektin në fjalë kishin mbetur prindërit e tij H dhe H A.

Kolegji i Apelit po ashtu konsideron se me të drejtë Shkalla e parë ka konstatuar se është e pakontestueshme se për paluajtshmërin dhe objektin parcelën nr. ..ZK Mitrovicë pronë e ish Jugobanka (MIT101), me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të 20/67 të dt. 09.03.2022, ishte miratuar shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme, për realizimin e projekteve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i ish objektit të "Jugobanka" Filiala në Mitrovicë, për nevoja të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, parcelat (toka dhe objekti) ish prona shoqërore nr..dhe

..ZK Mitrovicë. Po ashtu siç nuk ishte kontestuese se Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit kishte aprovuar transferimin e pronës –prona e paluajtshme me parcelat (toka dhe objekti) nr. .dhe ..ZK Mitrovicë nga ish NSh "Jugobanka" në Mitrovicë, në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për nevojat e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, vendim ky që ishte në përputhje me vendimin për shpronësim 20/67 të dt. 09.03.2022, andaj aktgjykimi i Shkalles së parë konsiderohet si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Andaj për këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e paditëses –AKP-së dhe të paditurës H A si të pa bazuara dhe vërteton Aktgjykimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Paditësja/ankuesja AKP ka paguar taksën në shumë prej 100 euro më 22 maj 2024 gjyqësore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë ndërsa e paditura lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 02 gusht 2024

Mr. Sc Sahit Sylejmani , Gjyqtar kryesues _____